

SHPLLJE / NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

Në përputhje me dispozitat 3, 86, 99 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (sipas amandamentimit me Ligjin Nr. 05/L-118, Ligjit Nr. 08/L-102 dhe Ligjit Nr. 08/L-262) në fuqi në Republikën e Kosovës, përmbartuesi privat Destan Bujupaj, ka sjellë Konkluzionin për lëndën P.nr. 313/22, të datës 05.12.2024, mbi shitjen përmes ankandit publik të sendeve të luajtshme të regjistruara (inventarizuara) dhe të sekuestruara në favor të kreditorit **MCM CITY CENTER SH.P.K.** me numër unik identifikues (NUI) 810535859, me numër regjistrimi të biznesit (NRB) 70399600, dhe me numër fiskal (NF) 600297067, me seli në Sheshin Nëna Terezë, Nr. 29/8, 10000 Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Besim Osmani, me adresë të zyrës në Rr. Zenel Salihu, nr.120, Kati III/8, 10000 Prishtinë.

Kjo pasuri e sendeve të luajtshme të regjistruara (inventarizuara) dhe të sekuestruara sipas sipas Procesterbalit dhe Aneksit të procesverbalit të datës 11.04.2024, nga ana e Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, si dhe të vlerësuar nga eksperti vlerësues Emin Plakaj sipas Ekspertizës së vlerësimit të datës 10.06.2024 të plotësuar me datë 23.07.2024, është pronë e debitorit **Ilir Maçani B.I.**, emri tregtar **N.H. RINGS**, me numër unik identifikues (NUI) 811301887, me numër regjistrimi të biznesit (NRB) 70454005, dhe me numër fiskal (NRF) 600069604, me adresë në Rr. Luan Haradinaj, nr. 11/2-29, 10000 Prishtinë, me pronar Ilir Maçani, të cilin e përfaqësojnë Avokatët Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, të dy me seli të zyrës në Rr. Rexhep Luci, Hyrja 20, Kati III-të, Nr. 11, 10000 Prishtinë.

Sipas autorizimit, kjo pasuri do të shitet përmes ankandit publik me qëllim të sigurimit të mjeteve për përmbushjen e detyrimeve (shlyerjen e borxheve) që debitori Ilir Maçani B.I., emri tregtar N.H. RINGS, që ka ndaj kreditorit MCM CITY CENTER SH.P.K.

DETAJET E ANKANDIT PUBLIK:

Data e Ankandit: 20.12.2024

Koha e shitjes: 09:30

Vendi i shitjes: Rr. Perandori Dioklecian, obj.4, nr. 15, 10000 Prishtinë

Lloji i sendeve: Inventari i restorantit N.H. Rings, përfshinë karrike, tavolina, pajisje kuzhine, gota, lugë, piru, dhe pajisje të tjera. Për më shumë detaje, të interesuarit mund të kontaktojnë zyrën e përmbartuesit privat dhe të kërkojnë kopjen elektronike të Aneksit të procesverbalit të datës 11.04.2024 që përmban listën e të gjitha sendeve të luajtshme të ofruara për shitje.

Vlera e pasurisë (sendeve të luajtshme): Vlera e pasurisë (sendeve të luajtshme) është vlerësuar në shumën prej 238,790.00 € (dyqind e tridhjetë e tetë mijë, e shtatëqind e nëntëdhjetë Euro) sipas ekspertit vlerësues Emin Plakaj sipas Ekspertizës së vlerësimit të datës 10.06.2024 të plotësuar me datë 23.07.2024.

Andaj, në përputhje me dispozitat ligjore njoftohen të gjithë të interesuarit se do të organizohet Ankandi Publik për shitjen e sendeve të luajtshme si më poshtë në respektim të kushteve të mëposhtme të pjesëmarrjes:

KUSHTET E PJESËMARRJES NË ANKAND PUBLIK

1. Të gjithë të interesuarit duhet të regjistrohen para ankandit deri më datë 19.12.2024. Regjistrimi mund të bëhet duke kontaktuar me shkrim përmes e-mail-it Përmbartuesin Privat Destan Bujupaj, me adresë në Rr.Perandori Dioklecian, obj.4, nr. 15, 10000 Prishtinë, E-maili: dbujupaj@dblaw-ks.com ose për cdo

informatë shtesë të interesuarit mund të kontaktojnë drejtëpërdrejtë me Përmbaruesin Privat në numrat e telefonit si në vijim: Mob. +383 44 347 641 ose Tel. +383 38 748 178.

2. Të gjithë të interesuarit duhet të paraqesin dokumentet e nevojshme për identifikim dhe duhet të depozitojnë 10% (dhjetë përqind) të vlerës së sendeve të luajtshme si kaucion (sigurie). Depozita/Kaucioni duhet të paguhet më së largu deri më 19.12.2024, në zyrën e Përmbaruesit Privat ose në ndonjërin ga bankat komerciale të licencuara në Kosovë.

RREGULLAT E ANKANDIT PUBLIK:

1. Ankandi do të zhvillohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga ligji.
2. Vetëm ofertuesit që përmbushin kërkesat ligjore dhe kanë depozituar kaucionin e nevojshëm do të pranohen në ankand.
3. Çmimi ose oferta e dhënë duhet të përfshijë të gjitha sendet e luajtshme (nuk lejohet ndarja dhe shitja e pjeshme e sendeve) të listuara në aneksin e procesverbalit.
4. Vlera e pasurisë (sendeve të luajtshme) është vlerësuar në 238,790.00 € (dyqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë Euro) dhe mund të shitet nën vlerën e përcaktuar, por jo më pak se 50% (pesëdhjetë përqind) të vlerës së përcaktuar nga eksperti vlerësues.
5. Fituesi i ankandit është pjesëmarrësi që ofron çmimin më të lartë dhe përmbush detyrimet financiare brenda afatit të caktuar.
6. Kaucioni i ofruesve të pasuksesshëm do të kthehet pas përfundimit të ankandit.
7. **SHËNIM ME RËNDËSI:** Të gjitha sendet shiten në gjendjen në të cilën ndodhen dhe nuk ka kthim apo garanci pas shitjes.

PRETENDIMET PËR TË DREJTAT MBI SENDET E LUAJTSHME:

Nëse ndonjë palë pretendon të drejtë pengu ligjor, kontraktuar, ose tjetër formë të regjistruar të pengut, duhet të dorëzojë: (a) dëshmi për pengun e regjistruar; (b) lista e sendeve/aseteve me specifikat përkatëse; (c) dokumentacion plotësues për verifikim; si dhe dokumente tjera që mund të kërkojnë nga përmbaruesi privat për të verifikuar sendet e luajtshme.

INFORMACIONE SHITESË:

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni përmbaruesin privat Destan Bujupaj në:

Emri dhe mbiemri: Destan Bujupaj – Përmbarues Privat
Adresa: Rr. Perandori Dioklecian, obj.4, nr. 15, 10000 Prishtinë,
Email: dbujupaj@dblaw-ks.com
Tel: +383 38 748 178
Mob: +383 44 347 641